



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 13-052/01-0000609/26
No. 06.01.2026
Data 06.01.2026



Republika e Kosovës/ Republika Kosova/ Republic of Kosova
Komuna Skenderaj/ Opština Skenderaj/ Municipality of Skenderaj
Drejtoria për Inspektion/ Direkcija za inspekciju/ Directorate for Inspection

DATË/A:	06.01.2026
PËR/ZA/TO:	Sekretaria e Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH	Arkivit
NGA/OD/FROM	Drejtore i Inspektionit, Valon Haliti
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT-	Raport Pune për Periudhën Janar - Dhjetor 2025

RAPORT PUNE PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2025

Drejtoria për Inspektion për zbatimin e planit vjetor të punës për vitin 2025, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi që ka për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve relevante, gjatë periudhës janar - dhjetor në të gjitha fushat që mbulon ka zhvilluar aktivitete të vazhdueshme me qëllim të përmbushjes së qëllimeve dhe objektivave që ka kjo drejtori.

Prioritetet kryesore të drejtorisë gjatë këtij viti ishin: mbrojtja e shëndetit të qytetarëve nga produktet jo të sigurta për konsum, mbrojtja nga praktikat mashtruese tregtare, qasja e papenguar në hapësira publike dhe ruajtja e tyre, transporti i sigurtë, rritja e sigurisë në trafik, mjedisi i pastër, mbrojtja nga degradimi urban, etj. Aktivitetet për secilën fushë që janë realizuar në kuadër të kësaj drejtorie janë përshkruar si në vijim.

Gjithsej në vitin 2025 janë shqyrtuar 296 lëndë. 212 lëndë janë miratuar, 80 lëndë janë refuzuar dhe 4 lëndë të anuluar.

FUSHA E TREGUT

Duke u bazuar në:

- **LIGJIN NR. 03/L-181 PËR INSPEKTORATIN DHE MBIKËQYRJEN E TREGUT**
- **LIGJI NR. 04/L-078 PËR SIGURINË E PËRGJITHSHME TË PRODUKTEVE**
- **LIGJI NR. 06/L-034 PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT**
- **LIGJI NR. 2004/18 PËR TREGTINË E BRENDSSHME**
- **RREGULLORET KOMUNALE**

Inspektorët e tregut kanë realizuar këto aktivitete:

- ☒ Janë inspektuar operatorët që merren me shitjen e produkteve ushqimore, furrat dhe shitësit e derivateve.
- ☒ Janë inspektuar 273 biznese, ndër të cilat janë dhënë 77 vërejtje me procesverbal për parregullsitë e hasura, para shqiptimit të masave ndëshkimore. Gjatë vitit 2025 janë regjistruar 25 biznese të reja. Për plotësimin e kushteve minimale teknike janë shqyrtuar 15 kërkesa, 10 prej tyre janë pajisur me pëlqim, 5 kërkesa janë refuzuar.
- ☒ Për produkte jo të sigurta, të dëmtuara, me afat të skadimit si dhe pa deklaracion, si dhe mashtrimi në peshë dhe mospërputhja çmim-arkë, shitje e duhanit për persona nën moshën 18 vjeçare janë pranuar 8 ankesa nga konsumatorët të cilat janë shqyrtuar me korrektësi. Në 8 raste të ankesave kemi marrë masa ndëshkimore ku janë shqiptuar gjoba në vlerë: 1x100€, 4 x 400€, 2 x 500€, 1x600€.
- ☒ Janë konfiskuar gjithsej **420 produkte ushqimore dhe jo ushqimore**, si dhe **mjete piroteknike**, të cilat nuk ishin të sigurta për konsum, ishin të dëmtuara, pa deklaracion ose me afat të skaduar, në vlerë totale **932.55 €**, si më poshtë:
 - ☒
 - Pije alkoolike dhe joalkoolike .
 - Produkte të mishit (mish i tharë, suxhuk, qofte, biftek, sallamë, etj.) – vlerë totale **525 €**;
 - Produkte ushqimore si keksë, ëmbëlsirë, hurma.
 - Produkte joushqimore 169 produkte.

Këto produkte janë asgjësuar nga **K.R.M. "Uniteti" – Skënderaj**

- ☑ Pas afateve të dhëna me procesverbale dhe vërejtjeve, ata të cilët nuk i kanë evituar ato, pas ankesave të pranura nga konsumatorët dhe me inspektimeve të shitësve ambulator, në bashkëpunim me zyrtarët policorë janë lëshuar 17 gjoba mandatore, në shumën prej 16,900.00 €.
- ☑ Kemi zbatuar vendimin nr. 1120/01 nga MTI për rregullimin e çmimeve të produkteve të naftës.
- ☑ Prioritet tjetër ka qenë dhe do të jetë luftimi i informalitetit (tregtia në të zezë), si dhe angazhimi në shërbim të qytetarëve edhe jashtë orarit zyrtar si vikendeve ashtu edhe gjatë festave. Kemi bërë thirrje për qytetarët që në rast të parregullsive të lajmërohen në zyrën e drejtorisë apo të kontaktojnë në nr. e telefonit 0800-1100 në kuadër të MTI-së në Prishtinë.
- ☑ Qytetarët janë ftuar që për çdo parregullsi të lajmërojnë në Zyrën e Drejtorisë ose të thërrasin në numrin **0800-1100** në kuadër të M.T.I.-së në Prishtinë (thirrja falas), për ankesa që lidhen me çmimet, mospërputhjen raft-arkë, sasinë, faturën, deklaracionin dhe sigurinë e produkteve.

Janë shqiptuar këto gjoba për subjektet e më poshtme:

1. Mosprezentim i dokumenteve – **3 raste**
(mosprezentim i dokumenteve të kërkuara nga inspektorët)
2. Shitje pa faturë tatimore – **2 raste**
(blerësit nuk janë pajisur me faturë tatimore apo kupon fiskal)
3. Produkte ushqimore – **3 raste**
(produkte me afat të skaduar dhe pa deklaracion)
4. Mashtrim me çmime – **3 raste**
(mospërputhje e çmimit raft-arkë)
5. Mosrespektim i afatit të dhënë – **2 raste**
(parregullsitë nuk janë evituar brenda afatit)

6. Mosvendosje e çmimeve – **3 raste**

(çmimet nuk janë të vendosura në përputhje me legjislacionin në fuqi)

7. Shitje e duhanit për persona nën moshën 18 vjeçare – **1 rast**

Paraqitja tabelare e punëve të kryera në fushën e tregut gjatë kësaj periudhe kohore:

Aktiviteti i inspektorit	Nr. i aktiviteteve
<i>Vizita në biznese</i>	273
<i>Vërejtje për biznese</i>	77
<i>Biznese të reja (pas vërejtjeve)</i>	25
<i>Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave</i>	15 K. 8 A.
<i>Fletëparaqitje në gjykatë - Kërkesa të përmbaruesi</i>	Nuk ka
<i>Gjopa të shqiptuara</i>	17 (16,900.00 €)

FUSHA E KOMUNIKACIONIT

Duke u bazuar në:

- **LIGJIN NR. 04/L-170 PËR TRANSPORTIN RRUGOR**
- **RREGULLOREN PËR TRANSPORTIN RRUGOR NË TERRITORIN E KOMUNËS SË SKENDERAJT NR.1-110-32837**
- **RREGULLORE PËR AUTO-TAKSI, TRANSPORT TË UDHËTARËVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË SKENDERAJT NR. 1-110/32825**
- **RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA, MGARKESA DHE GJOBA, KOMUNA SKENDERAJ NR.01-110/01-0025382/22**
- **UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MI) NR 09/2017 PËR SINJALIZIM DHE RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR**

☒ Gjatë kësaj periudhe raportuese janë hartuar 29 procesverbale, nga të cilat 23 kanë qenë kërkesa të shqyrtuara, 21 janë aprovuar si dhe 2 është refuzuar.

☒ Kemi punuar në transportin publik ku kemi bërë kontrolle operatorëve ekonomik të transportit publik ndaj të cilëve është shqiptuar 1 gjobë:

- ✓ 1 gjobë në vlerë 100 € ndaj kombi taksive pa leje pune i cili është hasur duke bartur udhëtarë

Të gjitha punët në transportin publik i kemi realizuar në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.

Transporti publik mbulohet nga 11 operator transportues të licencuar në MI dhe të pajisur me rende të udhëtimit nga Drejtoria për Shërbime Publike, si dhe 12 auto taxi dhe 2 radio-taksi me nga 5 automjete.

RENDET E UDHETIMIT NE TRANSPORT LOKAL

Memi Bus Sh.P.K.	18.03.2024	18.03.2027	Sami Hoxha
Memi Travel Sh.P.K.	18.03.2024	18.03.2027	Kujtim Hoxha
N.T.Sh. Vellezërit Rustemi	18.03.2024	18.03.2027	Valon Rustemi
N.T.P. Vllezërit Ferizi Sh.P.K.	18.03.2024	18.03.2027	Arsim Ferizi
N.T.Sh. Balli Trans	18.03.2024	18.03.2027	Beçir Shala
Arta Tours Sh.P.K.	18.03.2024	18.03.2027	Mexhit Smajli
N.T.P. Fationi Bus	18.03.2024	18.03.2027	Hamit Fetahu
Joni Travel Sh.P.K.	18.03.2024	18.03.2027	Avni Ademi
N.T. Zekaj Turs	18.03.2024	18.03.2027	Faton Veliqi
Ismajli Ahmeti B.I.	18.03.2024	18.03.2027	Ismajl Ahmeti
Zeqa Tours Sh.P.K	18.03.2024	18.03.2027	Zeqir Syla

Operatoret auto-taksi dhe radio-taksi te cilët kanë leje pune janë :

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Data e lëshimit	Data e skadimit
1	Gëzim Zena	05.03.2024	05.03.2029
2	Ramiz Osmani	05.03.2024	05.03.2029
3	Bekim Malaj	05.03.2024	05.03.2029
4	Visar Behramaj	05.03.2024	05.03.2029
5	Ismet Maloku	05.03.2024	05.03.2029
6	Afrim Gjinofci	05.03.2024	05.03.2029
7	Tafil Ahmeti	05.03.2024	05.03.2029
8	Smajli Meha	05.03.2024	05.03.2029
9	Blerim Sadiku	05.03.2024	05.03.2029
10	Xhevdet Spahiu	05.03.2024	05.03.2029
11	Sefedin Hasanaj	14.05.2024	15.05.2029
12	Valdet Prokshi	18.08.2025	18.08.2030

13	Isa Rushiti – Radio Taxi Blendi	05.03.2024	05.03.2029
14	Endrit Lushtaku – Radio Taxi Diti	05.03.2024	05.03.2029

Situacioni I

Nr.	PËRSHKRIMI	Njesia	Sasia
1	Vija horizontale 15 cm gjerësi, me ngjyrë njëkomponetëshe	m ²	518
2	Vendkalimet për këmbësor me ngjyrë njëkomponetëshe	m ²	486
3	Furnizimi me barriera gome	m ²	70
4	Furnizimi me shenja te komunikacionit nga alumini me foli reflektuse 3M me trashësi 2 mm me ram 600X600X600 mm	copë	72
5	Furnizimi dhe vendosja e tabelave dyfaqësore për emërtim të rrugëve 80x25 cm	copë	55
6	Pasqyrë rrugore Ø 60cm	copë	10
7	Furnizimi me shtylla te zinguara Ø60 3m te gjata, betonimi dhe thellësia 40X40X50	copë	125

Situacioni II

Nr.	PËRSHKRIMI	Njesia	Sasia
1	Vija horizontale 15 cm gjerësi, me ngjyrë njëkomponetëshe	m ²	1169
2	Vendkalimet për këmbësor me ngjyrë njëkomponetëshe	m ²	890.4
3	Furnizimi me shenja te komunikacionit nga alumini me foli reflektuse 3M me trashësi 2 mm me ram 900X900X900 mm	copë	8
4	Furnizimi me shenja te komunikacionit nga alumini me foli reflektuse 3M me trashësi 2 mm me ram 600X600X600 mm	copë	67
5	Furnizimi dhe vendosja e tabelave dyfaqësore për emërtim të rrugëve 80x25 cm	copë	25
6	Pasqyrë rrugore Ø 60 cm	copë	1
7	Furnizimi me shtylla te zinguara Ø60 3m te gjata, betonimi dhe thellësia 40X40X50	copë	87
8	Furnizimi me shtylla te zinguara Ø60 3m te gjata, betonimi dhe thellësia 40X40X50	copë	11

Situacioni III

Nr.	PËRSHKRIMI	Njesia	Sasia
1	Vija horizontale 15 cm gjerësi, me ngjyrë njëkomponentëshe	m ²	862.07
2	Vendkalimet për këmbësor me ngjyrë njëkomponentëshe	m ²	937.5

Situacioni IV

Nr.	PËRSHKRIMI	Njesia	Sasia
1	Vija horizontale 15 cm gjerësi, me ngjyrë dykomponentëshe	m ²	125
2	Vendkalimet për këmbësor me ngjyrë dykomponentëshe	m ²	70
3	Furnizimi me shenja te komunikacionit nga alumini me foli reflektuse 3M me trashësi 2 mm me ram 600X600X600	cop	1
4	Furnizimi me shtylla te zinguara Ø60 3m te gjata, betonimi dhe thellësia 40X40X50	cop	8
5	Pasqyrë rrugore Ø 60 cm	cop	13
6	Furnizimi me shtylla te zinguara Ø60 4m te gjata, betonimi dhe thellësia 40X40X50	cop	15

Gjithashtu kemi punuar në sinjalizimin vertikal dhe horizontal ku kemi bërë vendosjen e këtyre shenjave:

Vendosjen e sinjalizimit horizontal – vijës gjatësore dhe vendkalimeve për këmbësorë e kemi bërë në rrugët e qytetit. Punët në sinjalizimin horizontal janë kryer gjatë natës në mënyrë që të mos ketë pengesa nga automjetet. Po ashtu, kemi bërë vendosjen e sinjalizimit vertikal në rrugët e qytetit, si dhe në rrugët kryesore të fshatrave.

Kemi punuar në komisione për performancë komunale, ku kemi bërë raporte në fushat e transportit publik dhe hapësirat publike, kemi mbikëqyrur punët pas caktimit si menaxher i kontratës në kontratën për asfaltimin e rrugëve në fshatrat: Klinë e Poshtme, Klinë e Mesme, Klinë e Epërme, Makermal dhe Rakinicë.

Gjithashtu, kemi punuar në lëmi të ndryshme së bashku me kolegët, si dhe punë të tjera që na janë urdhëruar nga drejtori, ku kemi punuar edhe pas orarit të punës, gjatë festave, si dhe ditëve të vikendit.

Paraqitja tabelare e punëve të kryera në fushën e komunikacionit gjatë kësaj periudhe kohore:

<i>Aktiviteti i inspektorit</i>	<i>Nr. i aktiviteteve</i>
<i>Procesverbale</i>	29
<i>Lëndë të shqyrtuara -kërkesa të qytetarëve</i>	23
<i>Gjoba</i>	1 X 100 €
<i>Fillimi i procedurës përmbarimor</i>	-

FUSHA E MBROJTJES SË MJEDISIT

Gjatë kësaj periudhe kohore janë realizuar aktivitete inspektuese, mbikëqyrëse dhe vlerësuese duke u bazuara në ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret komunale për mbrojtjen e mjedisit siç janë:

- **LIGJI NR.03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT**
- **LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA**
- **UDHËZIMI ADMINISTRATIV MMPH NR. 01/2017 PËR DHËNIEN E LEJES MJEDISORE KOMUNALE**
- **RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E SKENDERAJT**
- **RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA - KOMUNA SKENDERAJ**
- **RREGULLORE KOMUNALE PËR SHËRBIME PUBLIKE**

Rëndësi të veçantë ka pasur monitorimi dhe inspektimi në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të planit të punës si:

- ☑ Është bërë shqyrtimi i 40 kërkesave të qytetarëve dhe evidentimi i 2 rasteve gjatë inspektimeve në terren për problemet në rrjet të kanalizimit, bllokimit, rrjedhjes së ujërave të zeza dhe shkaktimit të ndotjes nga këta faktorë. Rastet e evidentuara me procesverbale janë drejtuar në Drejtori për Shërbime Publike dhe në Drejtori të Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, ku është bërë intervenimi për rastet e raportuar nga Drejtoria e Inspektionit.
- ☑ Janë dhënë 8 urdhëresa ndaj operatorëve për rregullimin e krijimit të pikave statike për grumbullimin e mbeturinave në objektet banuese kolektive.
- ☑ Janë dhënë urdhëresa tek 20 operatorë në fazë ndërtimi që mbeturinat inerte t'i dërgojnë në pikën e grumbullimit të caktuar nga komuna dhe të mos i lënë në punishte.
- ☑ Hapësirat publike dhe ato përpara objekteve ku veprojnë operatorët ekonomikë janë monitoruar, dhe për to janë dhënë urdhëresa për mirëmbajtje.

- ☑ Janë shpërndarë urdhëresa për bizneset që ushtrojnë veprimtari brenda qytetit për mbjelljen e drunjve dekorativ. Urdhëresa është shpërndarë pranë rreth 50 operatorëve ekonomikë, me theks të veçantë te operatorët ndërtues.
- ☑ Mbikëqyrja e 15 lejeve mjedisore komunale për veprimtaritë që ndikojnë në cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës, të pranuar nga DUMA në vitin 2025, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i lejeve mjedisore të lëshuara në vitet paraprake.
- ☑ Gjatë inspektimeve në terren janë evidentuar 20 deponi ilegale të mbeturinave në zona urbane, breza rrugorë, parqe, rrjedha ujore dhe komplekse pyjore. Këto raste janë raportuar në Drejtorinë për Shërbime Publike, ku deponitë ilegale janë eliminuar, janë vendosur tabela sinjalizuese dhe për hedhjen e mbeturinave jashtë vendeve të përcaktuara janë shqiptuar gjoba: 10 gjoba në vlerë prej 200 euro për mbeturina inerte, 2 gjoba në vlerë prej 200 euro për mbeturina në brezin e rrugës, 1 gjobë në vlerë prej 500 euro për hedhje të asfaltit të gërryer jashtë vendeve të caktuara, dhe 4 gjoba të tjera për raste të veçanta.
- ☑ Mbikëqyrja e deponisë për materiale ndërtimore inerte në 'Dell' të Qirezit, si dhe mbikëqyrje dhe bashkëpunim me KRM 'UNITETI' për aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave, si dhe me NPL 'Eko Natyra' Sh.A. për aktivitetet e pastrimit të hapësirave publike.
- ☑ Aktivitete inspektuese për ruajtjen e mjedisve urbane dhe e peizazhit natyror brenda, në periferi e ndërmjet qendrave banuese, si rrugët trotualet, mjediset e përbashkëta në lagjet e banimit, mjediset e gjelbëruara, parqet periferike.
- ☑ Bazuar në Ligjin nr. 08/l-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/l-060 për Mbeturina, Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha dhe Rregullore Komunale për Shërbime Publike në Skenderaj janë shqiptuar 21 gjoba:
 - Për hedhjen e mbeturinave në brezin e rrugës janë shqiptuar 2 gjoba në vlerë prej 200 euro, ndërsa për hedhjen e mbeturinave inerte jashtë vendeve të përcaktuara janë shqiptuar 10 gjoba në vlerë prej 200 euro.

- Për hedhjen e mbeturinave inerte nga ballkoni i objektit është shqiptuar një gjobë në vlerë prej 70 euro, ndërsa për hedhjen e mbeturinave në natyrë është shqiptuar një gjobë në vlerë prej 30 euro.
 - Për shkelje që lidhen me hedhjen e asfaltit të gërryer jashtë vendeve të përcaktuara në infrastrukturën rrugore, është shqiptuar një gjobë në vlerë prej 500 euro.
 - Për dëmtim të drunjëve dekorativ në hapësirë publike janë shqiptuar 3 gjoba, përkatësisht në vlerë prej 100, 200 dhe 300 euro.
 - Për shkelje që lidhen me djegien e mbeturinave janë shqiptuar gjithsej 3 gjoba, prej të cilave 2 në vlerë 100 euro dhe 1 në vlerë 500 euro, në përputhje me shkallën e dëmit të shkaktuar.
- ☑ Verifikim dhe monitorim i aktivitetit të fabrikave në periferi të qytetit, si dhe i fabrikave të tjera, në lidhje me ndikimin në mjedis.
 - ☑ Janë evidentuar 167 drunj dekorativë në rrugët '17 Shkurti', 'Osman Geci', 'Fadil Rustemi' që nuk janë zhvilluar, megjithëse kanë pasur lulëzim në pranverë dhe rasti është përcjellur tek Drejtoria e Shërbimeve Publike.
 - ☑ Janë dhënë urdhëresa për kthimin në gjendjen e mëparshme të infrastrukturës së prekur gjatë punimeve në rrjetin e ujërave atmosferike dhe ujësjellësit, me qëllim sigurimin e funksionalitetit dhe mbrojtjen e mjedisit.
 - ☑ Gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare në terren, në dy raste të konstatuara, është evidentuar vendosje e kontejnerëve/shportave të mbeturinave në lokacione që nuk janë të destinuara për këtë qëllim, të cilat kanë ndikuar në krijimin e deponive ilegale, pasi në afërsi të tyre kanë hedhur mbeturina edhe persona të tjerë, duke cenuar pastërtinë

publike dhe rendin mjedisor, me ç 'rast është dhënë urdhëresë për largimin e tyre të menjëhershëm dhe rikthimin e gjendjes në përputhje me standardet përkatëse.

- ☑ Janë monitoruar hapësirat e gjelbra publike dhe janë dhënë urdhëresa për ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre, duke përfshirë mirëmbajtjen e zonave ekzistuese, largimin e automjeteve të parkuara në mënyrë të parregullt, duke u koordinuar me akterët relevant me qëllim ruajtjen e natyrës dhe përmirësimin e estetikës urbane brenda qytetit.

Paraqitje tabelare e punëve të kryera në fushën e mbrojtjes së mjedisit gjatë periudhës janar-shtator, nga inspektorja e tregut, Antigona Miftari e autorizuar për të mbuluar këtë fushë në mungesë të inspektorit të mjedisit:

<i>Aktivitetet</i>	<i>Nr. i aktiviteteve</i>
<i>Procesverbale</i>	<i>26</i>
<i>Kërkesa të qytetarëve/Lëndë</i>	<i>30</i>
<i>Njoftime zyrtare</i>	<i>0</i>
<i>Urdhëresa</i>	<i>28</i>
<i>Gjoha mandatore</i>	<i>18</i> <i>(3400 €)</i>
<i>Fillimi i procedurës për kundërvajtje – Masë përmbartimore</i>	<i>0</i>

Paraqitje tabelare e punëve të kryera në fushën e mbrojtjes së mjedisit gjatë periudhës kohore shtator-dhjetor:

<i>Aktivitetet</i>	<i>Nr. i aktiviteve</i>
<i>Procesverbale</i>	<i>15</i>
<i>Kërkesa të qytetarëve/Lëndë</i>	<i>10</i>
<i>Njoftime zyrtare</i>	<i>0</i>
<i>Urdhëresa</i>	<i>50</i>
<i>Gjoba mandatore</i>	<i>3 (900€)</i>
<i>Fillimi i procedurës për kundërvajtje - Masë përmbartimore</i>	<i>0</i>

FUSHA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Duke u bazuar në:

- **RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA - KOMUNA SKENDERAJ**
 - **RREGULLORE KOMUNALE PËR SHËRBIME PUBLIKE**
- ☒ Largimi i mallrave në bulevardin 'Ilaz Kodra', dhe parandalimi i shitësve ambulantë në trotuare.
 - ☒ Janë obliguar bizneset që të pajisen me leje për shfrytëzimin e parkingjeve si dhe t'a mirëmbajnë hapësirën përpara lokaleve të cilët i shfrytëzojnë.
 - ☒ Informimi i qytetarëve lidhur me procedurat dhe përgjegjësitë e tyre në raport me shërbime publike.
 - ☒ Monitorimi i zbatimit të masave të rekomanduara pas inspektimeve.
 - ☒ Mbikëqyrja e mirëmbajtjes verore dhe dimërore të shesheve, rrugëve dhe trotuareve në zonën urbane dhe rurale të komunës.
 - ☒ Kontribut në parandalimin e ndotjes dhe mbrojtjen e mjedisit përmes mbikëqyrjes së shërbimeve publike.
 - ☒ Mbikëqyrja e rrjetit të ndriçimit publik, e kycjeve në rrjetin e kanalizimit, ujësjellësit dhe shërbimeve tjera komunale.
 - ☒ Janë pranuar dhe trajtuar ankesa të qytetarëve që kanë të bëjnë me funksionimin e rrjetit të kanalizimit kryesisht lidhur me bllokime, derdhje të ujërave të zeza, erëra të pakëndshme dhe dëmtime të pusetave. Pas verifikimit në teren, në rastet ku është konstatuar nevoja për ndërhyrje përmes procesverbalit është njoftuar Drejtoria për Shërbime Publike për sanimin e problemit.

- ☑ Janë konfiskuar **6 aparate të boksit** të cilët kanë qenë të vendosur dhe aktiv pa leje në hapësirë publike.
- ☑ Inspektimi i hapësirave publike duke parandaluar dëmtimet, keqpërdorimet dhe shfrytëzimet e paautorizuara me ç'rast janë marr masa:
- ✓ **1 gjobë në vlerë 100 euro** ndaj personit i cili është hasur duke ushtruar veprimtari pa leje në hapësirë publike.
- ✓ **1 gjobë në vlerë 150 euro** ndaj personit i cili ka shkaktuar dëme në hapësirë publike.
- ☑ Gjatë kësaj periudhe kam ushtruar detyrën e menaxheres së kontratës **për rrënimin e objekteve të vjetra dhe objekteve të ndërtuara pa leje**, bazuar në vendimet e organeve kompetente dhe në përputhje me kushtet kontraktuale. Ne kuadër të kësaj kontrate janë realizuar punime të rrënit në gjithsej **8 objekte**, konkretisht : **3 lokale të vjetra në fshatin Prekaz i Epërm, 4 lokale në fshatin Rezallë dhe një objekt në fshatin Klinë e Epërme**. Për secilin rast është bërë planifikimi i punimeve, koordinimi me operatorin ekonomik dhe mbikëqyrja e drejtpërdrejtë në teren.

Paraqitja tabelare e punëve të kryera në fushën e shërbimeve publike gjatë kësaj periudhe kohore:

<i>Aktivitetet</i>	<i>Nr. i aktiviteteve</i>
<i>Procesverbale</i>	65
<i>Kërkesa të qytetarëve/Lëndë</i>	5
<i>Njoftime zyrtare/ Urdhëresa</i>	5
<i>Gjoba mandatore</i>	2

FUSHA E NDËRTIMIT

Duke u bazuar në:

- **LIGJIN NR. 04/L-110 PËR NDËRTIMIN**
- **LIGJIN NR. 04/L-175 PËR INSPEKTIMET**
- **LIGJIN NR. 05/L-031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE**
- **UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 05/2017 PËR STANDARDET MINIMALE DHE PROCEDURAT PËR MBIKËQYRJE INSPEKTIVE DHE LËSHIM TË CERTIFIKATËS SË PËRDORIMIT.**
- **UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.05/2017 PËR MBIKËQYRJE INSPEKTUESE DHE PROCEDURËN PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATËS SË PËRDORIMIT.**

Gjatë kësaj periudhe raportuese:

- ☒ Janë bërë inspektime të fazave të ndërtimit, urdhëresa për ndërprerje te përkohshme të punimeve deri të pajisen me leje ndërtimore, dhe urdhëresa për eliminim të parregullsive si dhe urdhëresa për respektim të kushteve ndërtimore.
- ☒ Janë bërë pranime teknike të objekteve ndërtimore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pranimet teknike janë bërë në kuadër të kompetencave ligjore me qëllim të verifikimit të përmbushjes së kushteve për përdorim të objekteve.
- ☒ Janë shqyrtuar 57 lëndë; 39 lëndë janë aprovuar ndërsa 18 janë refuzuar, arsyeja e refuzimit ishte bërë për mungesë të kompetencave, dokumentacion të mangët ose mosrespektim të afateve ligjore.
- ☒ Për tejkalim të lejes ndërtimore është shqiptuar një gjobe në vlerë 1,000€ .
- ☒ Për mosrespektim të vendimit të lëshuar dhe vazhdim të punimeve ndërtimore, ndaj subjektit është iniciuar kallëzim penal për veprën penale 'Ndërtim i kundërligjshëm'.

Paraqitja tabelare e punëve të kryera në fushën e ndërtimit gjatë kësaj periudhe kohore:

<i>Aktiviteti i inspektorit</i>	<i>Objekte banimi + Afariste</i>	<i>Objekte pa leje ndërtimi</i>	<i>Objekte me leje ndërtimi</i>
<i>Nr. i inspektimeve</i>	67	4	25
<i>Procesverbale, aktvendime, vendime për rrënim</i>	67	-	-
<i>Vërejtje/Urdhëresa</i>	6	-	-
<i>Kërkesa të qytetarëve/Lëndë</i>	94		
<i>Kërkesa</i>	65	-	-
<i>Vendime për rrënim</i>	2	-	-
<i>Aktvendime</i>	1	-	-
<i>Pranime teknike</i>	8	-	-

Paraqitja tabelare e punëve të kryera në fushën e ndërtimit gjatë periudhës prill – korrik 2025 (4 muaj) nga Inspektorja e Shërbimeve Publike, Edona Rexhepi e autorizuar ta mbulojë pozitën e Inspektorese së Ndërtimit.

<i>Aktivitetet</i>	<i>Nr. i aktiviteteve</i>
<i>Procesverbale</i>	45
<i>Kërkesa të qytetarëve/Lëndë</i>	37
<i>Njoftime zyrtare</i>	-
<i>Urdhëresa</i>	-
<i>Gjoha mandatore</i>	1 (1,000€)

ANGAZHIMI I INSPEKTORËVE JASHTË ORARIT TË RREGULLT TË PUNËS

Inspektorët e profileve të ndryshme varësisht nga natyrat e aktiviteteve janë angazhuar edhe jashtë orarit zyrtar, gjatë vikendeve dhe festave zyrtare për:

- Shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve dhe ftesave të zyrtarëve policor për mbyllje të lokaleve që ushtrojnë veprimtari pa leje pune.
- Mbikëqyrjen e zbatimit të Rregullore Komunale për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës.
- Mbikëqyrjen e sinjalizimit horizontal në rrugët e qytetit, konkretisht vijës gjatësore dhe vendkalimeve e këmbësoreve gjatë natës në mënyrë që të mos ketë pengesa nga automjetet.
- Kontrolla inspektuese në transportin publik.
- Intervenimi në rasteve të zjarrvënies dhe hudhjes së mbeturinave jashtë vendeve të caktuara.
- Mbikëqyrjen e zhvillimit të aktiviteteve ndërtimore në zona ndërtuese.
- Mbikëqyrjen e hapësirave publike duke parandaluar dëmtimet, keqpërdorimet dhe shfrytëzimet e paautorizuara.